



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 562/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk në procedurën e prokurimit me Nr. REF-66003-04-30-2018, me objekt: “*Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godines së institucionit me roje private*” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.920.000 lekë pa tvsh zhvilluar më datë 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Dibër.

Autoriteti kontraktor:

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Dibër
Lagja “Gjok Doçi”, (ish-klinika dentare), Peshkopi, Dibër.

Ankimues

“Grand Security” sh.p.k.
Maqellarë, Dibër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimueit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën. 1, të nenit. 63, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.05.2018, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. REF-66003-04-30-2018, me objekt: “*Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private*” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.920.000 lekë pa tvsh zhvilluar më datë 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Dibër.

II.2. Në datën 14.05.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) për një roje dhe një vendroje në muaj për periudhën 12 muaj, përkatësisht:

1. "Kevenjo" shpk	2915926.45	skualifikuar
2. "Grand Security" shpk	2915926.45	skualifikuar
3. "International Security Albania" shpk	2915926.45	kualifikuar
4. "Safe" shpk	2915926.45	kualifikuar
5. "Trezhnjeva" shpk	2915926.45	kualifikuar
6. "Eurogjici Security" shpk	2915926.45	kualifikuar
7. "Snajper Security" shpk	2915926.45	kualifikuar
8. "Nazeri 2000" shpk	2915926.45	kualifikuar
9. "RES- 03" shpk	2915926.45	kualifikuar

II.3. Në datën 28.05.2018 operatori ekonomik "Grand Security" shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyen si më poshtë vijon:

"Nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2014,2015,2016 sipas pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe pikës 2 ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014,2015,2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës. Nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2014. Në këto kushte operatori ekonomik skualifikohet".

II.4. Në datën 30.05.2018, operatori ekonomik "Grand Security" shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, duke kërkuar kualifikimin e ofertës, në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Sipas renditjes së ardhur në sistem kuptuam se operatori ekonomik "Grand security" shpk është skualifikuar në këtë procedurë prokurimi për arsyet e mëposhtëme:

"Nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2014,2015,2016 sipas pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe pikës 2 ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014,2015,2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës. Nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2014. Në këto kushte operatori ekonomik skualifikohet".

Kjo është arsyaia që KVO ka vendosur që operatori ekonomik "Grand Security" shpk të skualifikohet në mënyrë të paligjshme e duke shkelur ligjin e PP, barazinë dhe konkurrencën për operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Nga mesazhi i ardhur në sistem kuptuam që operatori ekonomik "Grand Security" shpk, është skualifikuar kot, duke shkelur ligjin deri në pa kufi autoriteti kontraktor bashkë me KVO-në me qëllim vetëm për të favorizuar firmën fantazëm "Res-03" shpk.

Për dijeni:

Në nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “ 1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Në nenin 20 “Mosdiskriminimi”, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.”.

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 5, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose.”....., ndërsa po këtu pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë

organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në dokumentat e tenderit tek Shtojca.8, Kriteret e veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Pika.2.2.2, autoriteti kontraktor ka kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës.”.

Operatori ekonomik “Grand Security” shpk ka paraqitur bilancet e viteve 2015, 2016, 2017 të sigluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër dhe me bilanc aktiv të qëndrueshëm, duke u nisur dhe nga ecuria e firmës për vitin 2018, sipas pikës 2.2.2, të cilat janë të bashkalidhura në SPE.

Duke u nisur nga sa më sipër kërkoj që të kualifikohet oferta e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk.

II.5. Në datën 04.06.2018, me shkresën nr. 357/1 prot, datë 04.06.2018, shoqëria “Grand Security” shpk është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor me pretendimin si më poshtë:

Më datën 01.06.2018, ora 11:00, u mblodh komisioni për shqyrtimin e ankesave për tenderin me objekt: “Shërbim i ruajtjes me roje private për nevojat e DRSH Dibër“, i cili e konsideron të drejtë vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (Nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2014,2015,2016 sipas pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe pikës 2 ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014,2015,2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës. Nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2014. Në këto kushte operatori ekonomik skualifikohet) dhe vendosi të mos pranojë ankesën e bërë nga ana juaj.

II.6. Në datën 07.06.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Grand Security” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime që kishte parashtruar edhe tek autoriteti kontraktor.

II.7. Me shkresën me nr. 388/1 prot, datë 18.06.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 1070/2 datë 21.06.2018, me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës me arsyen se: “Sipas rendities së ardhur në sistem kuptuam se operatori ekonomik “Grand security” shpk është skualifikuar në këtë procedurë prokurimi për aresyet e mëposhtme:

“Nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2014,2015,2016 sipas pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe pikës 2 ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014,2015,2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës. Nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2014. Në këto kushte operatori ekonomik skualifikohet”.

Kjo është arsyeja që KVO ka vendosur që operatori ekonomik “Grand Security” shpk të skualifikohet në mënyrë të paligjshme e duke shkelur ligjin e PP, barazinë dhe konkurrencën për operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Nga mesazhi i ardhur në sistem kuptuam që operatorin ekonomik “Grand Security” shpk, është skualifikuar kot, duke shkelur ligjin deri në pa kufi autoriteti kontraktor bashkë me KVO-në me qëllim vetëm për të favorizuar firmën fantazëm “Res-03” shpk.

Për dijeni:

Në nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “ 1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Në nenin 20 “Mosdiskriminimi”, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo

procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.”.

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 5, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose.”....., ndërsa po këtu pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në dokumentat e tenderit tek Shtojca.8, Kriteret e veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Pika.2.2.2, autoriteti kontraktor ka kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës.”.

Operatori ekonomik “Grand Security” shpk ka paraqitur bilancet e viteve 2015, 2016, 2017 të sigluar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër dhe me bilanc aktiv të qëndrueshëm, duke u nisur dhe nga ecuria e firmës për vitin 2018, sipas pikës 2.2.2, të cilat janë të bashkalidhura në SPE”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën.8, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Pika.2.2.2, autoriteti kontraktor ka kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës.”.

III.1.2. Nga verifikimet ne sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes “Grand Security” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrë financiare të vitit 2015, të vulosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër.
- Pasqyrë financiare të vitit 2016, të vulosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër.
- Pasqyrë financiare të vitit 2017, të vulosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gëmbra “b” e Ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;”.

III.1.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 4, gërma “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Referuar arsyes së skualifikimit të ankimuesit “Grand Security” shpk, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga ankimuesi, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit për mosparaqitjen e bilancit të vitit 2014, rezulton të jetë i vërtetë. Konkretisht në SPE ankimuesi ka dorëzuar bilancet e viteve 2015, 2016 dhe 2017, ndërkohë që nuk ka dorëzuar bilancin e vitit 2014. Duke qenë se kërkesa e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është shprehur qartësisht se *“Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës”* kjo do të thotë që operatorët ekonomik kanë qenë në dijeni të kësaj kërkesë.

Gjithashtu referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit në të cilat pranon se ka paraqitur vetëm bilancet e viteve 2015, 2016 dhe 2017, të cilat rezultojnë me fitim dhe për rrjedhojë plotëson pjesërisht kriterin lidhur me faktin se duhet të ketë aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) vetëm për vitet 2015 dhe 2016. Komisioni gjykon se megjithëse ligji nuk e ka parashikuar në mënyrë taksative se bilancet duhet të jenë pozitive, kërkesa për paraqitjen e bilanceve ka të bëjë drejtpërdrejt me krijimin e bindjes së autoritetit kontraktor për ecurinë e aktivitetit të operatorëve ekonomikë në kohë, i cili në një farë mënyre duhet të dëshmojë për qëndrueshmëri financiare, për aktivitet pozitiv në mënyrë që të ofrojë garanci për realizimin me sukses të kontratës.

Public Health Sector

Gjithashtu, Komisioni sqaron se operatori ekonomik ankimues, nuk e kanë kundërshtuar kriterin në fjalë të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, megjithëse kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tyre parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Grand Security” shpk nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk për procedurën e prokurimit Nr. REF-66003-04-30-2018, me objekt: “Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.920.000 lekë pa tvsh zhvilluar më datë 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Dibër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. 

Nr. 1070 Protokoli; Datë 07.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

Mendim Kundër

Unë, Kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), Evis Shurdha dhe unë Nënkryetarja e Komisionit Enkeleda Bega, nuk jemi dakord me arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit, për sa i përket ankesës me objekt: Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private” Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.920.000 lekë pa tvsh zhvilluar më datë 14.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Dibër, me palë ankimuese operatorin ekonomik “Grand Security” shpk.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës me arsyen se: *“Nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2014,2015,2016 sipas pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe pikës 2 ku thuhet: Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014,2015,2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës. Nuk ka paraqitur Bilancin e vitit 2014. Në këto kushte operatori ekonomik skualifikohet”,* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

I.1.1. Në shtojcën.8, *“Kriteret e veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Pika.2.2.2, autoriteti kontraktor ka kërkuar që: “Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (me fitim) gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015, 2016). Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet e tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës.”.*

I.1.2. Nga verifikimet ne sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Grand Security” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrë financiare të vitit 2015, të vulosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër.
- Pasqyrë financiare të vitit 2016, të vulosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër.
- Pasqyrë financiare të vitit 2017, të vulosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Dibër.

I.1.3. Në nenin 46, pika 1 gëmra “b” e Ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e*

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.”.

I.1.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 4, gërma “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.”.

I.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

I.1.6. Referuar arsyes së skualifikimit të ankimuesit “Grand Security” shpk, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga ankimuesi, gjykojmë se arsyeja e skualifikimit për mosparaqitjen e bilancit të vitit 2014, nuk është në përputhje me fymën dhe qëllimin e vendosjes së kriterit në drejtim të provueshmërisë së kapaciteteve ekonomike financiare të operatorit ekonomik ankimues. Sqarojmë se kriteri mbi bilancin nuk është qëllim në vetvete, por një element referues i cili i shërben AK për të krijuar bindjen se operatori ekonomik ka kapacitete financiare dhe mundësi për përmbushjen me sukses të kontratës.

Konstatojmë se ankimuesi ka dorëzuar në SPE bilancet e tre viteve të fundit 2015, 2016 dhe 2017, në përputhje të plotë me nenin 46, të LPP, duke dëshmuar kështu kapacitetet ekonomike financiare të nevojshme për realizimin e kontratës. Jo me kot, LPP ka specifikuar qartë se për të provuar kapacitetet ekonomike e financiare autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesmarrës dokumentacion deri në tre vitet e fundit. Referuar datës së zhvillimit të procedurës gjykojmë se tre vitet e fundit financiare në kuptim të ligjit janë pikërisht

2015,2016,2017 për të cilat ankimesi ka dorëzuar dokumentacionin përkatës. Mungesa e pasqyrave financiare për vitin 2014 nuk ka asnjë rëndësi thelbësore për autoritetin kontraktor në kushtet kur është dorëzuar dokumenti për vitin 2017, i cili për më tepër përmban të dhëna më koherente dhe më aktuale të veprimtarisë ekonomike të operatorit ekonomik ankimes krahasuar me vitin 2014. Autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale dokumentat financiare të paraqitura në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara. Në këto kushte gjykojmë se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimes “Grand Security” shpk për keëtëarsye nuk është i drejtë dhe operatori ekonomik ankimes duhet të kualifikohet në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Grand Security” shpk qëndron.

Kryetar
Evis Shurdha

Nënkryetar
Enkeleda Bega

